

**SHABAN SINANI**

***I PARILEMI NË TRAGJEDINË ABELI  
TË E. HAXHIADEMIT: VËLLAVRASËS  
PREJ FATIT APO PREJ FAJIT ADAMAH***

**I.**

Në një letër të disa kohëve më parë, drejtuar komitetit organizues shqiptar të Konferencës së 50-të të Studiuesve të Baladës, që do të organizohet në Tiranë e Gjirokastrë në shtator 2022, studiuesi britanik Thomas McKean, president i *Société Internationale d'Ethnologie et de Folklore* (*Commission internationale pour l'étude de la chanson populaire*), shkruante se do të ishte e mirëpritur që, në vigjilje të kësaj ngjarjeje të rëndësishme parësore jo vetëm për vendin mikpritës, një grup këngëtarësh të baladave kelte e irlandeze, të paraqitej me një repertor tradicional në Shqipëri, duke siguruar që ata, këngëtarët, do të mësonin e do të përfshinin në program dhe një baladë shqiptare.

McKean, duke dashur që në këtë shfaqje të kishte një përafrim të shkallës maksimale të motiveve të baladave shqiptare, kelte e irlandeze, shkruante: *We're looking forward to learning an Albanian song - please make some suggestions as to what to learn! It would be fun to learn one that has an equivalent in the Scottish tradition, so I could sing both of them. Are there Albanian ballads about: a) One sister killing another out of*

*jealousy?* b) *One brother murdering another over inheritance, or jealousy?*<sup>1</sup>.

Vëllavrasja për xhelozji a trashëgimi është edhe sot një motiv themelor në fondin e baladave në shumicën e traditave popullore europiane. Ka ekzistuar në mitologjitë e parakrishtera, sidomos në atë të lashtësisë greke, që është e mbushur kryekrejet me atëvrasës, mëmëvrasës e vëllavrasës, motive që u shërbyen tragjedianëve antikë për të krijuar kryeveprat e tyre. Në *Librin e Zanafillës* (4: 1-16) të *Besëlidhjes së Vjetër* ky motiv mori trajtën e *amzës*, *matrix-it*, për letërsinë që erdhi më vonë: në fillim në formën e folklorit dhe më pas edhe në dramaturgji. Në shekujt e humanizmit european u shfaq ajo që njihet si *Biblia pauperum*, qëllimi i së cilës ishte që, përmes ilustrimit, *to visualize the typological correspondences between the Old and New Testaments*. Kështu, në rrjedhë të shekujve e mijëvjeçarëve, vëllavrasja njohu së paku katër regjistra: *formën mitologjike*, *formën biblike*, *formën popullore* e *formën letrare-dramaturgjike*. Tragjedia *Abeli* e Etëhem Haxhiademit i përket kategorisë së fundme<sup>2</sup>.

Northrop Frye, që në studimin e hershëm të tij *Arketipet e letërsisë / Archetypes of Literature*<sup>3</sup>, më pas në mënyrë teorikisht

<sup>1</sup> Nga letra e antropologut britanik Thomas McKean drejtuar më 28 dhjetor 2021 komitetit organizues shqiptar të Konferencës së 50-të Ndërkombëtare të Studiuesve të Baladës.

<sup>2</sup> Ndër më të hershmit që janë marrë me veprën e Etëhem Haxhiademit përmendim: Vangjo Nirvana, “Etëhem Haxhiademi - dramaturg humanist”, në *Minerva*, nr. 23-24, Tiranë, 1934; Bardhi (Behar) Shtylla, “Tragjeditë e Haxhiademit”, në *Shkëndija*, nr. 4. Tiranë, 1941; Aleksandër Xhuvani, “Një tragjedi e re shqipe”, në *Illyria*, nr. 37, Tiranë, 1936; Elvira Tarro, “Etëhem Haxhiademi”, në *Tomorri i vogël*, nr. 6, 1942. Numri 55 i revistës *Poeteka* (Tiranë 2020) i kushtoi një rubrikë më vete paraqitjes retrospektive të mendimit kritik të hershëm (të receptimit të parë) për dramaturgjinë e Etëhem Haxhiademit.

<sup>3</sup> Shih tek Northrop Frye, “The Archetypes of Literature”, botuar në *The Kenyon Review*, vol. 13, nr. 1 (winter, 1951), f. 92-110.

të thelluar në veprën e njohur *The Great Code: the Bible and Literature*, zbuloi kushtëzimin vertikal të letërsisë prej Biblës (*The Bible and Archetypes*) dhe mitologjisë, të të dyjave bashkë me folklorin dhe letërsinë, duke arritur në përfundimin se ashtu sikurse *the two testaments form a double mirror, each reflecting the other*, ashtu *gjithçka që krijohet më vonë është rikrijim i së mëparshmes*: kodi i madh i letërsisë është Bibla.

Letërsia shqipe është në të njëjtën shkallë me atë botërore e kushtëzuar prej lëndës biblike. Këtu nuk është fjala vetëm për tre shekuj të letërsisë kishtare, prej Buzukut deri në shekullin XIX e më vonë, me karakter krijues, rikrijues e përshtatës, por për gjithë historinë e saj, prej fillimeve deri më sot. Periudha letrare midis dy luftërave është gjithashtu e tejmbushur me motive biblike-ungjillore, prej *Albumit të Nolit* e *Psalmes murgu të Asdrenit* deri tek tragjeditë e Etëhem Haxhiademit. Tragjedia e tij *Abeli* është një vepër me rëndësi themelore për çdo kërkim të orientuar në leximin biblik të letërsisë<sup>4</sup>, siç ka ndodhur e ndodh sot me letërsitë e mëdha<sup>5</sup>.

---

<sup>4</sup> Për vëmendjen që pati fituar vepra e Haxhiademit në rrethet e studiuesve jashtë vendit mund të këshillohet botimi *A history of modern drama* përgatitur nga Barrett Harper Clark e George Freedley, bot. nga *Appleton-Century Company*, New York 1947, f. 549; gjithashtu: *The Emory University Quarterly*, volumes 10-11, Emory University Press, 1954, f. 262. Shih dhe Alex Preminger (et alt.), *Encyclopedia of poetry and poetics*, bot. *Princeton University Press*, Princenton 1965, f. 9; ribot. 2016. Krhs. dhe Peter Nagy, Phillippe Rouyer, Don Rubin (edit.), *World encyclopedia of contemporary theatre*, volume 1 (Europe), bot. *Routledge*, 1988, f. 35. Edhe Giuseppe Schirò, në librin e tij *Storia della letteratura albanese*, bot. *Nuova accademia*, 1959, f. 239, i kushtoi vlerësim vendit të Etëhem Haxhiademit në historinë e letërsisë shqipe jo vetëm në dramaturgjë, por edhe në mjeshtërinë krijuese.

<sup>5</sup> Studiuesit e sotëm të letërsisë ruse, të bashkuar rreth shtëpisë botuese *K jedinstvu (Për bashkim)*, u kanë kushtuar pothuajse të gjithë autorëve të mëdhenj të letërsisë, secilit më vete, prej Pushkinit deri tek Shollohovi e poetët e *Brezit të argjendtë*, një vëllim studimesh me titull të përbashkët: *Shkrimtari dhe ortodoksia: Pushkin i pravoslavije* (Moskë 2007), *Gogol i pravoslavije* (Moskë 2004), *Lermontov i pravoslavije* (Moskë 2010), *Lomonosov i*

## II.

A është *parë lindja* një privilegj apo një fatalitet? Pikërisht kjo është pyetja që projekton Etëhem Haxhiademi në tragjedinë e tij *Abeli*. A ka të bëjë krimi vëllavrasës në këtë tragjedi me statusin e të *parilemit*, siç e shkruan Buzuku në *Mesharin* e tij (*u jam biri yt i pari lenë; aih më muor të parëtë e lenë tem*)?

Sipas *Librit të Gjenezës*, vëllavrasësi i parë në historinë e njerëzimit është Kaini. Me karakterin e saj gjenotipik dhe arketipal, shëmbëlltyra biblike e Abelit dhe Kainit (*motivi i Abdulit dhe Kenanit në Kur'an*) ka qenë tërheqëse në të gjitha kohërat për letërsinë dhe sidomos për dramaturgjinë botërore. Tragjedia *Abeli* e Etëhem Haxhiademit është nga më të vonat në historinë e kësaj gjinie dhe autorit i duhej të provohej me një vështirësi të nënkuptueshme: paracaktimi i fatit të karakterit në *Shkrimet e Shenjta*, në të drejtën kanonike (*ius canonicum*) nga njëra anë dhe shumësia e leximeve të karakterit të Kainit në letërsi përgjatë shekujve. *Krijonjësi shqipëtar ka para tij një shkëmb të madh që nuk mund t'a hedhë poshtë vetë pa kaluar vite me radhë krijimi letrar*, pati shkruar në mesin e viteve 1930 Elvira Tarro, një nga themelueset e studimeve letrare shqiptare, duke pasur parasysh pikërisht këtë horizont të ngushtë vetëveprimi krijues të Etëhem Haxhiademit.

Përveç këtyre vështirësive, duhet shtuar edhe kanuni tradicional shqiptar, që e rregullonte trashëgimin e shtëpisë njësoj si në të drejtën kanonike: *Mbas Kanunit, sundimi i shpis i përket ma të vjetrit nën kulm të shpis a se vllaut të parë* (*Kanuni i Lekë Dukagjinit*, nye i nandët, paragrafi 20), me një përjashtim: *Po*

---

*pravoslavije* (Moskë 2014), *Ahmatova i pravoslavije* (Moskë 2014), *Tostoj i pravoslavije* (Moskë 2009), *Dostojevskij i pravoslavije* (Moskë 2015), *Shollohov i pravoslavije* (Moskva 2013), *Rubcov i pravoslavije* (Moskë 2004). Kjo kolanë botimesh është e hapur dhe plotësohet çdo vit me lexime të reja biblike-ungjillore të autorëve rusë.

*s'patën ato veti qi duhen për me krye këtë zyre si e lyp detyra, atbotë zgjidhet kuvendisht prej shpijakve njaj, qi të jet ma i meçëm, i urtë e ma kujdestar.* Por ky përjashtim ngjan më shumë si një njohje në teori, sepse statusi i të parilemit është i paprekshëm në gjithë traditën etnojuridike shqiptare. Shtëpia trashëgohet prej më të madhit, edhe në qoftë se të lemit mbas tij janë ma të zot e ma me emën. Në nenin 35 të Kanunit të Lekë Dukagjinit trashëgimi i kreut të familjes përcaktohet shprehimisht sipas tagrit të parbinis (tagri i dialit t'parë): *Djalit të parë i përket sundimi i shpis mbas dekës së t'et; vllau i parë do të pvetet per gjithshka mbrenda e jashta shpijet* (neni 35, paragrafi 63/a dhe 63/b). Edith Durham shkruan se në viset veriore të Shqipërisë i zoti i shtëpisë (mbas dekët të kryezotit) zakonisht është vëllai i madh: *ky drejton dhe përfaqëson shtëpinë në katund, fis e kudo.* Dom Simon Filipaj, në përkthimin e Biblës (Botime Drita, Ferizaj, 2004), ka shenjuar formulën: *Je vëllau i plaktë, prijna me e marrë Krygjen e Krishit - puthe e fale ti se edhe na të ndigiojmë*, që përdorej për të nxitur më të madhin në moshë të printe pleqësinë për pajtime gjaqesh.

Interesante është që në trashëgiminë gojore të sllavëve të Jugut statusi i të parëlindurit nuk është ruajtur, dhe kjo vërehet që në emërtimin e vëllazërisë, pa emra që prijnë, thjesht *Hrnjici brati, vëllazërit Hrnjicë*, ndërsa shtëpia trashëgohet sipas formulës: *najmladi - najljući: më i vogli më i forti*. Së fundmi, le të përmendim se statusi i të parëlindurit, në pikëpamjen etike, edhe sot është me fuqi rregulluese, së paku për aq sa përmbahet në atë që quhet *parim i senjoritetit në mirësjellje*: në Kosovë vëllai i vogël duhet t'i drejtohet më të madhit me apelativin *bac*.

Etëhem Haxhiademit i duhej të përfillte a të shpërfillte jo vetëm kanonin biblik, jo vetëm *Abelët e Kainët* e shumë të kishte njohur historia e letërsisë, por edhe traditën etnojuridike, *ius laicum*. Para tij, Fan S. Noli, njohës i shkëlqyer i *Shkrimeve të Shenjta* dhe mendimtar liberal, jo vetëm që nuk e shtron pyetjen e *fajësisë së të parilemit, të të parëlindurit* (lat. *primogenitus*,

*primogenitura*), por e ndëshkon atë si fajtor të përjetshëm, kur, përmes figurës së Kainit, *identifikon të keqen fatale*. Në poezinë *Marshi i Barabajt*, me vargjet: *O stërnip i Kainit, tepdil si bari / Ti na shtyp e na shtryth e ti gjakun na pi*, ai Noli rishpall pa dilemë të keqen e trashëguar. Martin Camaj, shumë dekada më vonë, sërish do t'i drejtohej me respekt, si një të drejte kushtëzuese, parëlindjes: *I parilemiia mori ma tepër se të tjerët për të randë t'et afrimin me Lenën*.<sup>6</sup>

*Shembëlltyrën e Kainit dhe Abelit* e kanë konsideruar si rrëfimim e parë biblik për ndarjen e bujqësisë nga blegtoaria, një hap epokal që shenjon *fillimet e domestikimit të njerëzimit*: kur njeriu mësoi të ushqehet me bimët e tokës, u lidh me të. Kjo është arsyeja pse motivin e Abelit dhe Kainit studiuesit e kanë krahasuar me vepra të mëhershme (si *Punët dhe ditët* të Hesiodit) dhe të mëvonshme (si *Bukoliket e Gjeorgjiket e Virgjilit*<sup>7</sup>, tërthorazi edhe me *Bagëti e Bujqësinë* e Naimit).

<sup>6</sup> M. Camaj, "Pishtarët e natës", në *Vepra letrare*, n. 4, Apollonia, 1996, f. 45.

<sup>7</sup> Nuk mund të konsiderohet e rastit që Haxhiademi, siç njofton në letrën në formën e një autobiografie shkruar posaçërisht për Lasgush Poradecin dhe dërguar atij më 9 prill 1938, qysh kur ishte nxënës në Lecce i kishte lindur ideja e përkthimit shqip të *Bukolikeve* të Virgjilit: *Në Lecce kishja një profesor mjaft të zotin qi më pregatiste për gjuhën latinishte. Kur një ditë po me pregatiste për shkollë "Bukoliket" e Virgjilit, pa që u impresionova mjaft për bukurin e veprës. Më pyeti me buzëqeshje në se më pëlqen. I thashë se kur ta mësoj mirë gjuhën latine do t'a kthej këtë vepër në shqipet. Dhe me të vërtetë mbas tre vjetësh u mora me kthimin e "Bukolikeve" të Virgjilit, të cilën e ktheva jo krejt veprën në versin origjinal, në heksameter. Si bazë për përdorim të heksametrit në shqipet mora për model përkthimin e "Bukolikeve" në gjuhën gjermane nga Vossi, i cili asht po në heksametër, tyke marrë për daktila e sponde jo si të vjetrit gjatësin e rrokjeve, por theksat. Këto lloje heksametra në bazë të rrokjeve në gjermanishten (si ç'e dini edhe ju), përveç Vossi-t në përkthimin e Homerit e të Virgjilit, e përdori edhe Goethe-ja në "Hermanin und Dorothea". Pra, me përkthimin e "Bukolikeve" unë besoj se bana dy sherbime: 1). Jam i pari qi ktheva ne shqipet një poet latin; 2). Jam i pari qi përdora në gjuhën shqipe heksametrin si mbas modeleve qi përmenda ma sipër (rreth përdorimit të heksametrit nga unë shih edhe gazetën*

Kalimi prej jetës endacake në *habitat të përherëshëm*, në statusin e banuesit *in situ*, ishte një ndryshim cilësor, që shenjonte lindjen e një qytetërimi tjetër. Dhe, si çdo kapërcim i tillë, do të kërkonte flijimet e veta. I paracaktuari do të ishte sjellësi i së resë, Kaini, flijimet e të cilit as Hyji nuk i dëshiron.

Në leximet antropologjike, vëllavrasja e parë në histori është e përligjur prej faktit se *Kaini kishte statusin e parëlindjes*, status që ka një rol përcaktues në gjithë *Besëlidhjen e Vjetër*. Në tekstet kanonike, *i parëlinduri i çdo krijese është Hyji* (Kolosianëve: 1-15). Në *Librin e Daljes* ata që dhunuan popullin e Zotit *do të ndëshkohen me vdekjen e të parilemit*. Dy linjat e trashëgimit të bijve të Abrahamit, *me dy të parilemë nënash të ndryshme*, implikojnë në mënyrë paracaktuese raportet midis besimeve abrahamike: Hyji i jep urdhër Moisiut ... *tue i thënë: Shenjtëno për mue çdo dialë të parë, qi çel shtrat (barku) ndërmiet të bijvet Israelit (Të dalëtë, kapitla XIII, 1)*.

Jo më e paktë është fuqia e parëlindjes në letërsinë laike. Raportet midis Agamemnonit dhe Menelaut nga njëra anë dhe të Hektorit me Paridin nga ana tjetër janë të kushtëzuara deri në fatalitet prej këtij statusi. Parëlindja ka krijuar jo vetëm në letërsi, por edhe në trashëgiminë gojore, matricën e vet sovraane, që përmban raporte të mirëqena e të mirëpranuara. Muji dhe Halili në eposin e kreshnikëve ruajnë të njëjtin *status auctoritatis* si në gjedhen biblike. Me të gjithë *agt e Jutbinës* Muji mund të jetë një *primus inter pares*, kurse me Halilin raportet janë të rregulluara ndryshe. Halili, *vllau i vogël keqot*, edhe martesën e bën *për shkak të urdhrit të të parilemit*, për ndryshe, jeta e tij do të vazhdonte në aventura *për grabitje çikash në krajli*.

---

“Demokratia” të Gjirokastrës, nr. 453 datë 3 mars 1935). Citohet sipas botimit nga Makensen Bungo, në artikullin *Mbi poetin dramaturg Ethem Haxhiademi*, botuar në *Dielli*, 30 qershor 2014.

### III.

Shumë e vështirë për Etëhem Haxhiademin për t'iu përgjigjur pyetjes se çfarë mund të ndryshonte ai me tragjedinë e tij *Abeli*, në kushtet kur thujse e gjithë trashëgimia biblike-ungjillore dhe ajo laike e kishte pafajësuar Kainin duke e quajtur vëllavrasjen *në të drejtën e tij*, si *i parilemë*; apo më keq, si fatalitet i pashmangshëm duke qenë *i parilemi i njerëzisë si fryt i mëkatit*. Por e nevojshme për të kuptuar rëndësinë e ndryshimit që ai sollti për ta amnistuar Kainin jo me arsyen e gatshme kanonike, jo me klisheën e *fajit të trashëguar*, jo me dënimin prej mëkatit zanafillës, por me marrëdhëniet e padrejta në familjen e parë me të cilën nisi jeta njerëzore në këtë botë sipas këndvështrimit biblik<sup>8</sup>.

Mes dhjetëra e dhjetëra tragjedive të shkruara përgjatë mijëvjeçarëve për Kainin dhe Abelin, vepra e Etëhem Haxhiademit bën dallim për zbritjen e fajit dhe të përgjegjësisë nga vullneti hyjnor tek padrejtësia në familje. Nuk është pakënaqësia e Hyjit për flijimet e padenja të Kainit, përkundër *flijimeve erëkandshme* të Abelit, burimi i së keqes së madhe. Duke perifrastuar sërish Nolin, *Kaini nuk është fajtor se është lindur fajtor, por është fajtor se ka një shkak*. Dhe shkak është në rendin tokësor, në rendin brenda *familjes së parë*, e cila

<sup>8</sup> Një studim themelor kushtuar fajit / fatit tragjik në veprën Abeli të Etëhem Haxhiademit ka realizuar dr. Emin Emini, titulluar *Neoklasicizmi në dramaturgjinë shqiptare*, mbrojtur si tezë doktorate në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë 2020. Një trajtim krejt ndryshe paraqet studiuesi Aurel Plasari, në studimin *Ideologjia e dashurisë përballë ideologjisë së urrejtjes*, botuar më 1993, në hyrje të tragjedisë Abeli të Haxhiademit, Elbasan 1993, f. 79-86. Besa Shingjergji (Turku), në studimin monografik *Ligjërimit dramatik i Etëhem Haxhiademit, zë i veçantë në dramatikën shqiptare*, tezë doktorate mbrojtur në Departamentin e Letërsisë të Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë, Tiranë, 2016, nuk shpreh ndonjë interes të posaçëm për raportet midis Kainit, *të parilemit*, në Bibël, *parë lindjes* në të drejtën tradicionale dhe burimit të aktit tragjik në veprën e Haxhiademit.

ndërton raporte të privileguara me më të voglin. E gjitha kjo të sjell ndërmend një porosi prej letrave apostolike apokrifë, në të cilën thuhet: *Hyji do të bëjë gjithçka të mirë për ju, në pjesën tjetër kërkoni përgjigje nga vetja*. Nuk është *Perëndia-At* fajtori i vëllavrasjes, por padrejtësia brenda familjes shkaku i humbjes tragjike. Etëhem Haxhiademi, në veprën e tij, e zbret fajin nga qielli në tokë, duke e kthyer nga *fat tragjik* në *faj tragjik*. Nga të parët që e kishte vërejtur se Haxhiademi i bën bisht paraqitjes së Abelit dhe Kainit në mënyrë besnike me shëmbëlltyrën biblike, në kërkim të një Abeli dhe Kaini të vet, është Vangjo Nirvana, i cili konstaton se autori e sheh konfliktin mes dy vëllezërve *si një problem pedagogjie: S'ka fjalë se ky problem pedagogjik ka rëndësi të madhe. Dhe në përdorimin e kësaj theme Haxhiademi është dëftuar rousseau-ian, domethënë veprën e keqe të Kainit nuk ia heth natyrës së tij të keqe, po fajit të prindëvet, që donin më tepër Abelin nga ai. Symboli biblik i së ligës, symboli manikeist i protestës, Kaini bëhet te dramaturgu shqiptar symbol pedagogjik à la Rousseau. Çështje sensibiliteti artistik dhe psykosynthëze. Po ndër ne shqiptarët Kaini, me veprën e tij të vëllavrasësit, mund të mishërojë edhe dramën politike e kombëtare shqiptare të pesëmbëdhjetë vjetëvet të fundit. Dhe si protagonist i kësaj drame, Kaini në një tjetër tragjedi, po të shkruhet, mund të marrë edhe shtetësi shqiptare. Kainër dhe Abelër jemi një çikë që të gjithë, kush më pak kush më shumë, dhe si të tillë symbole të përjetëshme i jetojmë edhe në: dhe si njerës dhe si shqiptarë<sup>9</sup>. Këtij mendimi i janë mbajtur edhe disa studiues të mëvonshëm. Veprat e tij kanë karakter të theksuar edukativ dhe didaktik, shkruante Anton Çefa<sup>10</sup>.*

---

<sup>9</sup> V. Nirvana, art. cit. Krhs. dhe “‘Abeli’ dhe ‘Lyra’ të Etëhem Haxhiademit (ndërshtypje e gjykime)”, po ai, botuar në gazetën *Tomori*, nr. 19, 24 mars 1940.

<sup>10</sup> A. Çefa, “Klasicisti i letërsisë shqipe”, në *Mapo letrare*, 2 prill 2016.

Haxhiademi arrin të përcjellë të parën brerje ndërgjegjeje në histori, kur Adami dhe Eva nisin të arsyetojnë anësinë e tyre krimndjellëse në dashurinë ndaj fëmijëve:

*... Kët' dashni që lindi me pahirë,  
Kaini s'po e sheh me sy të mirë.  
Ay me vehte t'vet ndoshta mendon,  
Se nga i vllai ma tepër na ndihmon,  
Me gjith'këtë lakmojm'na mbi të rinë,  
E kjo po i krijon mbi t'vllan zilinë.*

Fragmentarizimi i fajit: **1)** Prej arsyes hyjnore (*mëkati i parë i prindërve, fëmija i parë drejtpërdrejtë* në rendin njerëzor, paracaktimi në formën e statusit të të parëlindurit etj.); **2)** Tek *patrikët* që keqsudojnë në tokë dhe që identifikohen me familjen e padrejtë dhe të padenjë nga njëra anë; **3)** Në anën tjetër *paditja e prindërve prej të dytëlemit, Abelit*:

*... Dhe të ftohët zemrën po ta ketë,  
Për muë, fajin e math e kemi vetë...  
Kainin me sy t'keq ju e shikoni,  
Se fort mâ pak nga un atë e doni,*

**4)** Më pas dhe njohja e hyrjes në rrugë të gabuar vetë patrikut të familjes:

*Dhe si armiq, o Ev' ke për t'i kqyrë  
Po nuk i pam' të dy na me nj'fytyrë,*

e çlirojnë Kainin prej natyrës kriminale dhe prej mallkimit të lartmë. Gjithë ky rrotullim gati-gati në invers të gjedhes që ekzistonte më parë, duke përfshirë eposin, kanunet, madje dhe rendin patriarkal dhe sjelljet sociale të kohës kur u shkrua tragjedia *Abeli*, përbëjnë risinë e Etëhem Haxhiademit si

dramaturg e mendimtar. Pikërisht fragmentarizimi i fajit, prej mallkimit zanafillës dhe mëkatit të parë tek rendi familjar i shtrembëruar; prej shpagimit të fajit të trashëguar deri tek nevoja për flijim, për t'i dhënë fuqi paracaktuese hierarkisë në familje, ndërtuar mbi parimin e më të madhit në moshë, e bën tragjedinë *Abeli* të ndryshme prej veprave të tjera të Haxhiademit, për të cilat Branko Merxhani shkruante se përmbajnë si karaktere *njerz që rrojnë jetën si një tragjedi kanë vdekjen e një heroit*. Sepse në tragjedinë *Abeli* ka njerëz që bëjnë jetë tragjike, por kurrfarë heroizmi nuk shfaqet, është një tragjedi pa hero.

Për Aurel Plasarin *Abeli* dhe Kaini shenjojnë dashurinë dhe urrejtjen, gjegjësisht paralajmërimin e natyrës së Krishtit dhe denoncimin e barbarisë<sup>11</sup>. Tomorr Plangarica, duke e karakterizuar veprën e Haxhiademit si *të dimensionuar në dy plane kryesore: njeriu me dashurinë dhe, sidomos me dhimbjen e tij - në këtë aspekt, që kap pjesën më të madhe të territorit dhe hapësirës së realitetit të tij artistik, gjëllin ndjesia për vajzën, gruan, nënën, vëllain, babain, mikun, poetin, patriotin, atdheun, bukurinë, shëmtinë, tmerrin, frikën, dhimbjen, fatkeqësinë, mëshirën, errësirën, dritën, gazin, shpresën, ëmbëlsinë, hidhërimin*, ngjan se pajtohet me Aurel Plasarin duke i parë Abelin dhe Kainin si shëmbëlltyra të dashurisë (Krishtit) dhe dhimbjes tragjike<sup>12</sup>. Për Vangjo Nirvanën (Vangjel Koçën) konflikti mes dy vëllezërve paraqitet në vepër si një ushtrim pedagogjik: e mira dhe e keqja, edukimi dhe egërsia. Për Emin Eminin është më shumë një dilemë tragjike që vjen prej fajit dhe fatit tragjik që bashkohen e shtyjnë njëri-tjetrin. Për një pjesë edhe më të madhe studiuesish konflikti i dy vëllezërve është më së shumti një qasje klasiciste ndaj një konflikti zanafillës. Stefan

---

<sup>11</sup> A. Plasari, "Ideologjia e dashurisë përballë ideologjisë së urrejtjes", në revistën *Nëntori*, nr. 1/1991; po ai, "Portret i vonuar i tragjikut Etëhem Haxhiademi", në *Drita*, 9 qershor 1991.

<sup>12</sup> T. Plangarica, *Univers i vlerave të munguara*, Botime Sejko, Tiranë 2002, f. 100.

Shundi (Gjergj Kuka), Vedat Kokona, Branko Merxhani, Sterjo Spasse, Fiqret Fterra, Muhamet Bala, Kudret Kokoshi, Namik Ressuli dhe të tjerë intelektualë që morën pjesë në vlerësimin e parë të veprave të Haxhiademit, iu drejtuan kryesisht aktualizimit atdhetar të motiveve zanafillëse: *Në radhët krenare të shpatëtarëve të literaturës së re shqiptare, ai ec me ballë të lidhun me dafinat e nderit. Shkrimtarë të temperamentit të Haxhiademit s'kanë nevojë për lëvdata, mbassi e kanë fitue me mundime të vazhdueshme vendin e tyne në literaturën shqiptare, shprehej Shundi*<sup>13</sup>.

Në këtë parashtrësë u munduam të provojmë se tragjizmi buron më shumë prej një shkakut tokësor - padrejtësisë brenda në familjen e parë - dhe se origjinaliteti i veprës gjendet në relativizimin e të dyja të drejtave, biblike e laike, absolute dhe relative, qiellore dhe tokësore, për t'i dhënë asaj origjinalitet dhe afri me jetën e zakonshme njerëzore. Nëse në motivin-matricë është Hyji që mallkon *adamah-un*, tokësorin; dhe pastaj edhe vëllavrasësin Kain, në tragjedinë e Haxhiademit mallkojnë e nëmin ata që s'e kanë këtë tagër, *adamah-ët, tokësorët*, shkaktarët e vërtetë të së keqes<sup>14</sup>:

*Qofsh i mallkuem, i poshtëm, ti përjetë,  
Prej nesh dhe prej Zotit të vërtetë;  
Zemra jote kurr' mos past' gëzime,*

<sup>13</sup> Gj. Kuka (Stefan Shundi), “A propos të një artikulli mbi Etëhem Haxhiademin: lidhur me një shkrim të Vangjo Nirvanës rreth tragjedisë “Skënderbeu” me autor Haxhiademin”, në *Drita*, nr. 113, Tiranë 15 prill 1937. Në studimin e Virion Graçit “Dramaturgjia e Etëhem Haxhiademit dhe skena e asaj kohe”, botuar në *ex-Libris*, 21 korrik 2021, lexuesi mund të gjejë një paraqitje tërësore të receptimit të parë të veprës së Haxhiademit, sidomos të leximit atdhetar të saj.

<sup>14</sup> Për lidhjet midis *adamah* dhe *Adam* shih *Libri i Gjenezës*: 2:7; 3:17; 4:10-12; 5:29. Gjithashtu: Ithamar Gruenwald, *Rituals and ritual theory in ancient Israel*, publ. Brill, Leiden-Boston, 2003, f. 60-62.

*N' mjerimin tand ne gjetshim ngushullime.  
Ti që na dhè për pleqëni kët' tmerr,  
Të bift n' vend t' grunit n' arën tande ferrë.  
Jo vetëm ti, por dhe fëmijët tuej,  
Mënin' e madhe paçin të gjithkujt,  
Paçin bashk' me urrejtjen e njerzis',  
Mallkimet e krijuesit të Gjithsis.*

Me të drejtë Emin Emini vëren se tragjizmi i Abelit ka dy shkallë fajësie: **a)** Faji i bartur sipas *Shkrimit të Shenjtë* dhe **b)** Faji i bartur nga marrëdhënia e deformuar shoqërore e morale, e shprehur në raportin prindër-fëmijë<sup>15</sup>.

Në fund të fundit, pyetjes nëse burimi i humbjes tragjike është: **a)** Mallkimi (paracaktimi) hyjnor, zemërimi i Perëndisë-At për mosbindjen e parë të *adamah*, për mëkatën e parë; **b)** *Flijimi eufemik* për të stabilizuar një herë e mirë një tabu jetëgjatë, pozitën e pacenueshme të *të parilemit* në familje, pavarësisht identitetit të tij dhe vlerave a kundërvlerave të tij; **c)** Padrejtësisë që ndodh ditë për ditë në familjen e parë duke ruajtur përkëdhelje e lëvdime për Abelin dhe përbuzje e mosmirënjohje për Kainin, autori i jep përgjigje duke theksuar këtë të fundit, padrejtësinë e prindërve. Drejt e kishte Bardhi (Behar) Shtylla : *Kur është i pajosur me fuqi artistike dhe poetike të mjaftë, auktori dramatik është vërtetë si demiurg, i afrohet një perëndije dhe kështu e mbyll rrethin midis krijesës dhe krijestarit.*<sup>16</sup> Ç'është e Hyjit, vjen prej tij; ç'është e krijesës së tij, e *adamah-ëve*, vetëm me rendin e sjelljeve të tyre mund të shpjegohet.

---

<sup>15</sup> E. Emini, *punim i cituar*, f. 55.

<sup>16</sup> Bardhi (Behar) Shtylla, "Tragjeditë e Haxhiademit", në *Shkëndija*, nr. 4. Tiranë, 1941, f. 124.

**BIBLIOGRAFI**

- Bungo, M., “Mbi poetin dramaturg Ethem Haxhiademi”, botuar në *Dielli*, 30 qershor 2014.
- Camaj, M., “Pishtarët e natës”, në *Vepra letrare*, n.4, Apollonia, 1996.
- Clark. H.B., Freedley. G., *A history of modern drama*, nga *Appleton-Century Company*, New York, 1947.
- Çefa. A., “Klasicisti i letërsisë shqipe”, në *Mapo letrare*, 2 prill 2016.
- Emini, E., *Neoklasicizmi në dramaturgjinë shqiptare*, mbrojtur si tezë doktorate në Akademinë e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 2020.
- Frye, N., “The Archetypes of Literature”, botuar në *The Kenyon Review*, vol. 13, nr. 1, 1951.
- Gruenwald, I., *Rituals and ritual theory in ancient Israel*, Botime Brill, Leiden-Boston, 2003.
- Kuka, Gj., “A propos të një artikulli mbi Etëhem Haxhiademin: lidhur me një shkrim të Vangjo Nirvanës rreth tragjedisë “Skënderbeu” me autor Haxhiademin”, në *Drita*, nr. 113, Tiranë, 15 prill 1937.
- Mirdita, Z., *Mitet dhe mitologjia në antikë*, Rilindja, Prishtinë, 1988.
- Nirvana, V., “Etëhem Haxhiademi” - dramaturg humanist, në *Minerva*, nr. 23-24, Tiranë, 1934.
- Nirvana, V., “‘Abeli’ dhe ‘Lyra’ të Etëhem Haxhiademit (ndërshtypje e gjykime)”, në gazetën *Tomori*, nr. 19, 24 mars 1940.
- Plangarica, T., *Univers i vlerave të munguara*, Botime Sejko, Tiranë, 2002.
- Plasari, A., “Ideologjia e dashurisë përballë ideologjisë së urrejtjes”, në revistën *Nëntori*, nr. 1/1991.
- Plasari, A., “Portret i vonuar i tragjikut Etëhem Haxhiademi”, në *Drita*, 9 qershor 1991.

Schirò, G., *Storia della letteratura albanese*, Nuova Accademia editrice, 1959.

Shingjergji, B., *Ligjërimi dramatik i Etëhem Haxhiademit, zë i veçantë në dramatikën shqiptare*, mbrojtur si tezë doktrate në Departamentin e Letërsisë, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Universiteti i Tiranës, 2016.

Shtylla, B., “Tragjeditë e Haxhiademit”, në *Shkëndija*, nr. 4., Tiranë, 1941.

Tarro, E., “Etëhem Haxhiademi”, në *Tomorri i vogël*, nr. 6, 1942.

Xhuvani, A., “Një tragjedi e re shqipe”, në *Illyria*, nr. 37.

